



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 80, datë 30.07.2019

**PËR NDALIMIN E KANDIDIMIT TË Z. SINAN TAJ NË VENDIN VAKANT
PËR GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, VAKANCË E PARAKOHSHME,
SHPALLUR NGA KUVENDI NË DATËN 28.08.2018**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Ardian Dvorani	- Kryetar/Relator
Vitore Tusha	- Zëvendëskryetare
Arta Marku	- Anëtare
Margarita Buhali	- Anëtare
Fatjona Memçaj	- Anëtare
Fatri Islamaj	- Anëtar
Eriol Roshi	- Anëtar

Asistuar nga sekretare **Dorina Dulaj**,

Me praninë e **Avokates së Popullit, znj. Erinda Ballanca**, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **z. Bledar Dervishaj**, përfaqësuesi i autorizuar i Presidentit të Republikës,

në mbledhjen e datës **30.07.2019**, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDATI PËR GJYQTAR

NË GJYKATËN KUSHTETUESE: Z. Sinan Tafaj

OBJEKTI:

Urdhërimi i ndalimit të kandidimit të **z. Sinan Tafaj**, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Kuvendi në datën **28.08.2018**.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtarit të Këshillit, **z. Ardian Dvorani**, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, znj. Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/c të Ligjit nr. 8577/2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”*, Kuvendi, në datën 28.08.2018, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e parakohshme, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të ish-gjyqtarit Fatos Lulo.

2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Kuvendi i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kritereve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese është edhe z. Sinan Tafaj.

4. Në zbatim të nenit 125 dhe 149/d të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 7/c të ligjit nr. 8577/2000, të neneve 229, pika 1 e nenit 234, 235, 236, 237, 239 e 240 të Ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, si edhe të pikës 98 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar në datën 05.04.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese.

5. Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 *“Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”*, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 05.04.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për secilin nga vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

6. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Kuvendi në datën 28.08.2018, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve, është caktuar anëtar i Këshillit, z. Ardian Dvorani.

7. Z. Sinan Tafaj, si njëri ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidatëve. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati Sinan Tafaj, gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

8. Në datën 12.04.2019, kandidati Sinan Tafaj është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidatëve së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

9. Në datën 15.04.2019, kandidati Sinan Tafaj ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklaramit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidatëve së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.

10. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr. 265 prot, datë 19.04.2019, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit nr. 8577/2000 dhe Ligjit nr.115/2016.

11. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidati Sinan Tafaj, ku tregohet se është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidatëve së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidatëve.

12. Me shkresën nr.2854/4 prot, datë 03.05.2019, ILDKPKI ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se kandidati Sinan Tafaj e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nga pika 2 e nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 për të dorëzuar të plotësuar pranë atij institucioni Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

13. ILDKPKI, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, me shkresën , nr.18/38 prot., datë 30.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Sinan Tafaj dhe personat e lidhur me të.

14. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 4 të nenit 229 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës “e” të pikës 20, 24, shkronjës “b” të pikës 60 e vijues të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, edhe ky Këshill ka kryer veprimet verifikuese të kërkimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit Sinan Tafaj dhe personave të lidhur me të.

15. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatit Sinan Tafaj, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 17.04.2019, i është drejtuar me kërkesa për informacion dhe ka marrë përgjigjet përkatëse me të dhënat e kërkuara nga secili prej institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidimit), si vijon:

a) Institucioneve bankare: (1) Banka Alpha Albania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Kreditit e Shqipërisë, (6) Banka e Parë e Investimeve, (7) Banka Intesa Sanpaolo, (8) Banka Kombëtare Tregtare, (9) Banka Ndërkombëtare Tregtare, (10) Banka Procredit, (11) Banka Raiffeisen, (12) Banka Societe Generale, (13) Banka Tirana dhe (14) Banka Union.

b) Institucione financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë : (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing, (3) Capital Invest, (4) Easypay sh.p.k, (5) Final sha, (6) Fondi Besa, (7) lutecredit Albania, (8) Landeslease, (9) M – Pay sh.p.k. (10) NOA sha, (11) Porsche Leasing, (12) Posta Shqiptare, (13) Raiffeisen Leasing, (14) Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF, (15) Tirana Factoring & Lease, (16) Tranzit sha, (17) Union Financiar Tiranë.

c) Subjekte financiare të licencuar nga AMF : (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit EVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal.

ç) Institucione të tjera publike si : (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (2) DPSHTRR, (3) D.P.Tatimeve, (4) M.Drejtësisë, (5) OSHEE, (6) QKB, (7) UKT.

16. Në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të gjitha institucionet publike dhe subjektet private të treguara në pikën 15 më sipër, kanë dërguar pranë Këshillit përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidatin Sinan Tafaj.

17. Në lidhje me rezultatet e kontrollit të ushtruar dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI, në datën 29.05.2019, Këshilli ka njoftuar kandidatin Sinan Tafaj në datë 31.05.2019, në rrugë elektronike, për të dhënë shpjegimet përkatëse mbi këto gjetje, si dhe të depozitojë çdo dokument justifikues që ai disponon.

18. Kandidati Sinan Tafaj, në datë 04.06.2019, në rrugë elektronike dhe në rrugë zyrtare, ka dhënë shpjegimet përkatëse dhe ka bashkëlidhur dokumentacioni justifikues, i cili është protokolluar pranë sekretarisë së KED-së.

19. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 82 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr.110 prot, datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidati Sinan Tafaj sipas ligjit nr. 138/2015.

20. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr.1134/191 prot., datë 28.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Sinan Tafaj.

21. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatis Sinan Tafaj, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i është drejtuar më kërkesë për informacion Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (*shkresa nr. 120 prot., datë 17.04.2019*), Shërbimit Informativ të Shtetit (*shkresa nr. 114 prot., datë 17.04.2019*), Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (*shkresa nr. 118 prot., datë 17.04.2019*) dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (*shkresa nr. 117 prot., datë 17.04.2019*).

22. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në vijim të procedurës së sipërcituar për verifikimin e integritetit, me shkresën nr.352 prot., datë 20.05.2019, i është drejtuar Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar të kërkuar pranë institucioneve përkatëse ligjzbatuese për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve.

23. Drejtorja e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme kanë dërguar përgjigjet e tyre, përkatësisht me shkresat *nr.1545 prot., datë 10.06.2019* dhe *nr.680/1 prot., datë 15.05.2019*.

24. Gjithashtu, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të Ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015, si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr.112 prot, datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidati Sinan Tafaj për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

25. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr.551/1 prot., datë 03.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Sinan Tafaj.

26. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c”) dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91/93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, krahas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës të depozituar nga vetë kandidati Sinan Tafaj në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant.

27. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*, Këshilli në datën 02.05.2019 i është drejtuar më kërkesë për informacion partive politike, si dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (*shkresa nr. 270 prot., datë 19.04.2019*), duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë. Në përgjigje të këtyre kërkesave, KQZ dhe parti politike kanë dërguar informacione lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin në ndonjë pozicion drejtues në parti politike të secilit prej kandidatëve, përfshirë edhe kandidatin Sinan Tafaj.

28. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikave 29, 75 dhe 87 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, duke vlerësuar paraprakisht se ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, anëtar i Këshillit relator i çështjes ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

29. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 30.07.2019, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt shqyrtimin e gjetje në procedurën e verifikimit të kandidimit të zotit Sinan Tafaj, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Kuvendi në datën 28.08.2018.

30. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidati Sinan Tafaj.

31. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

32. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 30.07.2019, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

33. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

34. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit Sinan Tafaj.

35. Në thelb, Avokati i Popullit, krahas qëndrimit të përgjithshëm se edhe për këtë rast nuk ka pasur nga KED në dispozicion dokumentacionin e plotë, ku bashkëlidhur akteve të procedurës së verifikimit mungojnë edhe një pjesë dokumenteve dhe përgjigjeve të sjella nga institucionet, mungesës së analizës në Relacion nga vetë relatori dhe se si do veprohet në rastet kur ILDKPI është shprehur negativisht për kandidatet, nëse KED duhet të caktojë ekspert për të shqyrtuar prapësimet e kandidatit etj. parashtrori se e ka të pamundur të japë një mendim përfundimtar.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

36. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidatit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për ndalimin e kandidimit të kandidatit Sinan Tafaj për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Kuvendi në datën 28.08.2018.

37. Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se :

“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteria të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.”

38. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;

- c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;
- ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;
- d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

- a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;
- b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;
- c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”

39. Kushtet e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të, sikurse janë edhe ato të përmendura në pikat 37 dhe 38 më sipër, duhet të plotësohen secila dhe të gjitha së bashku në mënyrë që kandidati të pranohet për tu vlerësuar dhe renditur sipas meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe më tej për tu përzgjedhur gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nga organi i emërtesës.

40. Për rrjedhojë, nëse kandidati për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese nuk plotëson qoftë edhe njërin prej kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, kjo do të përbënte motiv ligjor të mjaftueshëm për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për të vënë në bisedim dhe për të disponuar ndalimin e kandidimit, pa qenë më e nevojshme të arsyetojë për plotësimin ose jo të kushteve të tjera ligjore.

41. Nisur nga të dhënat dhe gjetjet që rezultojnë nga procedura e verifikimit për kandidatin Sinan Tafaj, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerësoi të bisedojë dhe të konkludojë pikësëpari në lidhje me plotësimin ose jo të kushtit ligjor të parashikuar nga shkronja “dh” e pikës 1 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

42. Për sa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, ILDKPKI, me shkresën nr.18/38 prot., datë 30.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Sinan Tafaj dhe personat e lidhur me të.

43. Në përfundim të analizës së hollësishme financiare të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruara nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarimin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Sinan Tafaj, ILDKPKI në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

44. Përfundimet e sipërcituara të ILDKPKI, bazohen në gjetjet vijuese të raportit të kontrollit:

- Vlera prej 190.000 lekë e blerjes në vitin 2007 të apartamentit me sip. 50.3 m2, Rr. "A.V.", Tiranë gjykohet të jetë e ulët.
- Vlera prej 1.200.000 lekë e blerjes në vitin 2006 të truallit me sip. 426 m2, Rr. "A.V.", Tiranë gjykohet të jetë e ulët.
- Çmimi i blerjes së tokës me sip. 3.422 m2 në vitin 2003 në "L", Dajt, prej 500 lekë m2, gjykohet të jetë i ulët.
- Nuk ka paraqitur situacionet e punimeve sipas fazave të ndërtimit, referuar kontratave dhe as dokumentacion justifikues financiar për likuidimin sipas fazave të punimeve, në vlerën totale 22.386.000 lekë të banesës ne Rr. "Xh.B.", Q., Tiranë.
- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për përftimin e shumës 354 euro/muaj nga shteti spanjoll, me statusin për jetë të pavarur.
- Rezulton se apartamenti me sip. 68.8 m2, rruga "M.Sh.", Tiranë, është blerë në datë 13.5.1999 në shumën 1.700.000 lekë (likuiduar nga EKB) dhe është shitur nga subjekti në datë 20.5.1999 në shumën 1.500.000 lekë.
- Sipas konfirmimit të DRT Tiranë, rezulton përfitimi i të ardhurave nga Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë për periudhën 2015 - mars 2019 dhe vetë shoqata konfirmon pagesën e sigurimeve shoqërore deri në datën 31.8.2018. Kandidati deklaron se është larguar nga shoqata prej vitit 2014.
- Rezulton se pagesa për doktoraturën, është përfituar bashkë me pagën nga Shoqata e të Verbërve, ashtu edhe me pagesën e verbërisë nga Njësia Administrative Nr.1, Tiranë.
- Deklaruar të ardhura nga qiradhënia e pasurive të paluajtshme prej 2.514.000 lekë, por DRT Tiranë nuk konfirmon deklarinimin e këtyre të ardhurave.
- Dokumentacion justifikues jo i plotë ligjor për burimin e krijimit të shumës totale 60.000 euro nga huadhënësit, F.T., O.T. dhe A.C. . Është i paqartë fakti i vendosjes si kundërshtëpërbllim për huat e marra, i pasurisë e cila nuk i është kthyer akoma kandidatit, ndërkohë që ky i fundit ka prona aktuale të regjistruara në pronësi të tij. Afati i kontratave të huave ka përfunduar në Qershor 2018.
- Mosdeklarim i të ardhurave nga aktiviteti i avokatisë (aktivitet të cilin e kryen prej vitit 1999). Sipas konfirmimit nga DRT Tiranë, të ardhurat janë deklaruar 0 (zero) lekë për vitin 2014, 2017, 2018 dhe 2019. Pavarësisht se nga përfitimi i statusit të të verbërit, subjekti përjashtohet nga pagesat për tatim taksa si person fizik (ligji nr.8098 datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit", neni 4"), ky fakt nuk përjashton mosdeklarimin e të ardhurave nga aktiviteti, si pranë organeve tatimore, ashtu edhe në deklaratën e interesave private të kandidatit.
- Është i panjohur burimi i krijimit të shumës 7.060.600 lekë nga E.G., për pagesën e apartamentit në bashkëpronësi me G.T.. Tek sesioni i hipotekave, nuk rezulton që apartamenti të jetë vendosur si kolateral për kredi.
- Kandidati apo bashkëshortja e tij, nuk kanë deklaruar pasurinë shtëpi banimi 1 kat në rrugën A.V., Tiranë, Nr.(***), në vlerën 1.200.000 lekë, përfituar me kontratë shitje banese nr. (***/***/rep/kol, datë 23.6.1997.
- Kandidati nuk ka deklaruar ndërtim pa leje, si dhe përfshirjen e tij në procesin e legalizimeve sipas deklaratës nr.prot. 3589, datë 24.12.2014 në Rr. "A.V." Tiranë.
- Është i paqartë pozicioni i subjektit si Kryetar i Shoqatës së të Verbërve, për blerjen nga kjo e fundit, të pasurisë njësi me sip. 35 m2 në vlerën 2.350.000 lekë, me datë 26.4.2017, pasi ai është larguar si President/Kryetar Shoqatë prej vitit 2014.

45. Nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, mbi gjetjet e sipërcituara, është njoftuar kandidati Sinan Tafaj në datë 04.06.2019, në rrugë elektronike, për të dhënë shpjegimet përkatëse mbi këto gjetje, si dhe të depozitojë çdo dokument justifikues që ai disponon.

46. Kandidati Sinan Tafaj, në datë 03.06.2019, ka depozituar shpjegimet përkatëse me nr. 376 prot. datë 05.06.2019 dhe ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues nëpërmjet të cilit, në thelb, parashtron se:

a) Nga pakujdesia në hetim është krijuar ideja sikur bëhet fjalë për një objekt banesë të padeklaruar dhe të palidhur me truallin e deklaruar në rrugën A.V. me sip.426 m2. Me pak vëmendje konstatohet se objekti banesë është pjesë e pronës së deklaruar më parë, pasi ajo ka qenë ngritur mbi truallin 426 m2 në rrugën A.V., blerë nga i njëjti pronar z. H.B. . Në kontratën shitje banese nr.(**) Rep/(**) Kol datë 23.06.1997 cituar nga organi kompetent hetimor, është thënë qartë se në çmimin prej 1.200.000 lekë përfshihet edhe vlera e truallit mbi të cilin ndodhet kjo banesë. Po në këtë kontratë kuptohet qartë se pronësia e truallit do ti kalojë blerësit të banesës, pra mua dhe bashkëshortes time në momentin që do të vërtetohet pronësia e shitësit mbi të. Pronësia e shitësit të banesës z.H.B. mbi këtë truall u realizua nëpërmjet komisionit të kthimit të pronave, gjë që bëri të mundur kalimin formal të pronësisë mbi truallin në vitin 2006 sipas kontratës që shoqëron deklaratën.

b) Lidhur me mosdeklarimin e ndërtimit pa leje dhe të procesit të legalizimit, përsëri hetimi nuk është thelluar për të zbuluar të vërtetën. Kam tentuar legalizimin e objektit duke paraqitur një kërkesë formale për legalizim, meqenëse isha dhe pronar i truallit. Rreth 4 vjet më parë, një inspektor ka verifikuar situatën në terren, pra rreth 1 vit më vonë nga aplikimi dhe më komunikoi se objekti nuk ekziston, kështu që nuk kemi çfarë të legalizojmë pasi objekti tashmë ishte i shembur. Unë ju drejtova institucionit përgjegjës ASHK Jug, i cili me shkresën nr.1283 datë 03.06.2019, konfirmon plotësisht faktin e pretenduar nga unë se objekti nuk ekziston më dhe se kërkesa ime për legalizim refuzohet. Bashkëngjitur këtij shpjegimi do të gjeni shkresën e cituar më lartë, si dhe fotografitë e mbetjeve të objektit. Pasuria banesë e pretenduar si e padeklaruar nga unë dhe bashkëshortja ime, nuk ekziston më dhe as nuk mund të legalizohet. Pra duke qenë se ajo nuk përbën më një pasuri, dhe nuk është objekt pronësie në qarkullim civil, nuk kishim çfarë të deklaronim as unë, as bashkëshortja ime.

c) Meqenëse jemi në të njëjtën pasuri, argumentoj edhe pretendimin e konstatimit të dytë, se vlera e 1.200.000 lekë është e ulët në blerjen e truallit.Siç është përcaktuar në kontratën e lartpërmendur, çmimi i truallit ka qenë i përfshirë brenda çmimit të banesës dhe është paguar në vitin 1997. Pra trualli dhe banesa në vitin 1997 kanë patur një çmim prej 1.200.000 lekë. Kalimi formal i pronësisë mbi truallin është bërë sipas detyrimit të përcaktuar në këtë kontratë. Pra është pasojë e një veprimi juridik me kusht. Vlera prej 1.200.000 lekë në vitin 1997 ka qenë një vlerë e konsiderueshme, por duhet dhe risku i mosrealizimit të pronësisë mbi truallin, risk ky i marrë përsipër nga ana ime.

ç) Lidhur me konstatimin mbi dokumentacion justifikues jo i plotë ligjor për burimin e krijimit të shumës totale 60.000 Euro nga huadhënësit, F.T., O.T. dhe A.C.. Është i paqartë fakti i vendosjes si kundërshpërblim për huat e marra, i pasurisë e cila nuk i është kthyer akoma kandidatit, sqarohet se :

- Për sa pretendohet për mungesë dokumentacioni të huadhënësit tim F.T., ai është në gjendje të provojë disponimin e kësaj shume që mua më ka dhënë hua. F.T., së bashku me vëllain e tij R.T., kanë punuar në Greqi për një periudhë të gjatë. Ata janë djemtë e xhaxhait tim, me të cilët kam pas, dhe vazhdoj të kem marrëdhënie shumë të afërta. Prej disa vitesh ata kanë ngritur një biznes të përpunimit të mermerit në fshatin Gjorm (Kurbini). Fakti se F.T. ka punuar në legalisht në Greqi, provohet nga vulat dhe vizat në pasaportë, si dhe një dokument pronësie mbi një automjet, të lëshuar nga autoritetet Greke. Bashkëngjitur do të paraqes dhe deklaratën e tij.

- Për sa i përket mungesës së pjesshme të dokumentacionit që provon disponimin e shumës objekt huaje të huadhënësit tim A.C. sqaroj se është nipi im, me të cilin kam marrëdhënie shumë të afërta. Ai është mjek gjinekolog pranë Spitalit "M.G.", si dhe ushtron profesionin në klinikën e tij private. Pavarësisht sa më sipër, ai ka punuar për shumë vite, veçanërisht gjatë viteve '90 në Itali në mënyrë të ligjshme, me leje qëndrimi, numër fiskal dhe busta-pagë, dokumet i cili do ti bashkangjitet deklaratës.

- Për sa i përket mungesës së pjesshme të dokumentacionit që provon disponimin e shumës objekt huaje të huadhënësit tim O.T. sqaroj se O.T. është nipi im, me të cilin kam marrëdhënie shumë të afërta. Ai është mjek stomatolog dhe e ushtron si profesion privat prej rreth 15 vjetësh. Shuma që më ka huazuar mua, ai e ka marrë hua tek një dajë i tij, i cili ka realizuar shit-blerje pronash, dhe ka një biznes në fushën e karburanteve. Këtij dokumenti do ti bashkangjitet kontrata e huas e lartpërmendur si dhe deklarata e O.T. .

- Bashkëlidhur gjendet dokumentacion plotësues, që provon se F.T., këto të ardhura i ka nga emigracioni në Greqi, A.C. nga të ardhurat në emigracion në Itali, ndërsa O.T., i ka huazuar nga daja i tij, për ti rihuazuar tek unë. Nëse do të jetë e nevojshme, huadhënësit e mi do të kërkojnë dokumenta shtesë në Greqi dhe Itali, por është një proces administrativ që zgjat, pasi ka kaluar dhe shumë kohë nga punësimi i tyre.

- Ndërsa lidhur me paqartësinë e vënies si garanci të të drejtës time për të pretenduar tokë në Gjorm, sqaroj se kontratat e huas janë nënshkruar në qershor të vitit 2016, kohë në të cilën unë nuk e kisha legjitimuar pretendimin tim. Me vendimin nr. (***) datë 06.02.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, unë e kam fituar pronësinë mbi atë tokë, dhe tashmë jemi në procesin e bisedimeve me të tre huadhënësit e mi, vendim gjyqësor të cilin ja kam bashkëngjitur deklaratës së dorëzuar pranë ILDKPKI, për të negociuar një zgjidhje të arsyeshme. Pavarësisht nga kjo, në bazë të këtyre kontratave, janë vendosur marrëdhëniet e besimit të plotë reciprok, të respektit dhe marrëdhënieve të ndërsjellta shumë të afërta. Në këto rrethana duhet mbajtur në konsideratë se marrëdhënia e ndërtuar nuk mund të konsiderohet një marrëdhënie tregtare me rregulla strikte, për shkak të marrëdhënieve familjare dhe personale. Unë kam deklaruar pronësinë mbi këtë tokë, kështu që ka qenë e mundur të merrej me mend edhe gjatë këtij hetimi.

d) Lidhur me konstatimin e parë se vlera e shtëpisë në rrugën A.V., me vlerë 190.000 Lekë nga motra ime N.C., sqaroj se në vitin 1999 po këtë shtëpi ia kam kaluar në pronësi motrës time me kërkesën e saj. Ky veprim juridik u krye pasi motra ime, për nevojat e saja familjare i nevojitej pronësia mbi një shtëpi. Me përmbushjen e nevojave të saj, ajo ma ktheu shtëpinë sipas kontratës që unë kam paraqitur. Diferenca mes çmimit të shitjes nga ana ime dhe pastaj i blerjes, ka brenda jo vetëm përmbushjen e nevojave të saj, por dhe respektin dhe vlerësimin e thellë në marrëdhënien ndërnjerëzore si vëlla e motër. Ky çmim nuk duhet konsideruar si

një çmim tregu, pasi bazohet në marrëdhëniet ndërfamiljare dhe nuk kemi të bëjmë me rregulla strikte komerciale.

dh) Lidhur me konstatimin se çmimi i blerjes së tokës me sip.3422 m² në vitin 2003 në L. Dajt, prej 500 lekë/m², gjykohet i ulët, ky truall është blerë me kontributin tim dhe të vëllezërve, me qëllim që në një të ardhme, të ndërtonim shtëpiat të gjithë së bashku. Blerja informale është realizuar në vitin 1994, me një sipërfaqe diku rreth 2800 m². Disa vjet më vonë, në kufijtë e kësaj prone, vëllai im i vogël, P.T., që jetonte në Gjermani, bleu në mënyrë informale rreth 600 metra tokë, me çmim prej 550 lekë/m². Lajthitja ime në deklarinimin 5501 lekë/m² i referohet këtij rasti.

Kjo tokë ka qenë tokë arë dhe e paregjistruar në hipotekë në emër të pronarit që realizoj shitjen informale. Kur ky proces përfundoi, u bë e mundur kalimi formal i pronësisë në vitin 2003, por në respekt të marrëveshjes me shkrim në vitin 1994, shitësi nënshkroi përfitimin e shumës jashtë zyrës me çmimin me të cilin ai kishte marrë kundërvlerën e kësaj toke. Për shkak se vëllezërit e mi ishin në emigracion dhe një motër u tërhoq, duke u zëvendësuar me një nga vëllezërit e tjerë, atëherë me mirëkuptimin e pronarit, ramë dakord që e gjithë sipërfaqja të kalonte në pronësi në emrin tim. Kjo sipërfaqe u nda fizikisht mes 5 vëllezërve, 3 prej të cilëve kanë bërë ndërtime informale. Në momentet e aplikimit për legalizim, sipas nevojave dhe ndarjes së bërë në terren, unë kam bërë shitjet formale si dhe dhurimin për vëllain e madh, për të cilin kishim kontribuar ne të tjerët.

Pra gjykimi se çmimi prej 500 lekë/m² është i ulët, nuk është objektiv dhe i saktë. Bazuar dhe në ligj, çmimi i referencës në vitin 2003 si tokë arë ka qenë më i ulët se 500 lekë/m². Siç provohet dhe nga marrëveshja informale e vitit 1994, kjo pagesë është realizuar në këtë kohë, pavarësisht se formalizimi i kalimit të pronës u bë kur u formalizua regjistrimi i këtyre sipërfaqeve në hipotekë. Bashkëngjitur është një kopje të kontratës informale të nënshkruar në vitin 1994.

e) Është i pasaktë dhe i pabazuar në ligj konstatimi se nuk kam paraqitur situacionet e punimeve sipas fazave të ndërtimit, referuar kontratave dhe as dokumentacion justifikues financiar për likuidimin sipas fazave të punimeve, në vlerën totale 22.368.000 lekë tek banesa në Rr. Xh.B.. Nuk janë dalluar llojet dhe natyrat e kontratave të sipërmarrjes dhe të porosisë. Kontratat bazë të sipërmarrjes me të cilat është realizuar ndërtimi janë 3, me firmën (****), të cilat kapin rreth 80% të vlerës së ndërtimit masiv. Grupi i dytë i kontratave janë ato të porosisë që lidhen me instalime dhe meremetime.

Përsa i përket kontratave të investimit, ato janë nënshkruar në vitin 2013 dhe 2 prej të cilave në 8 prill 2014. Referuar ligjit për tatim taksat dhe ligjit për ruajtjen e dokumentacionit, afati maksimal i tyre është 5 vjet. Në këto rrethana, pretendimi për të paraqitur fazat e punimit dhe justifikimet financiare nuk është i bazuar në ligj. Nëse gjatë hetimit do të kishte patur më shumë vëmendje, do të konstatohet se në kontratën e parë të vitit 2013, për ndërtimin e karabinasë, është përcaktuar se pagesat bëhen dhe nëpërmjet bankës. Nëse do të kontrollonin lëvizjet bankare, do të konstatohen pranë Investment Bank dhe tërheqjet që kam bërë nga llogaria ime në BKT dhe derdhjet në Investment Bank. Ky fakt është konstatuar dhe nga DPPP.

Përsa i përket kontratave të porosisë, ato kanë një natyrë tjetër me ato të sipërmarrjes, pasi të porositurit marrin përsipër vetëm kryerjen e punimeve, ndërsa blerja e materialeve është marrë përsipër nga unë. Realizimi i blerjeve është bërë nga të porositurit, mbi bazën e financimit që unë kam bërë në formën e paradhënies. Bashkëngjitur këtyre kontratave, unë kam paraqitur dhe mandat-pagesat e paradhënies.

Dokumentacioni për ndërtimin e kësaj shtëpie, nuk është bërë më qëllimin se do të vinte një ditë për të bërë transparencë, por për të mbrojtur interesat e mia ekonomike-financiare, pasi ishte i vetmi mjet për të më mbështetur në pamundësinë time për kontroll vizual. Ligji lejon edhe likuidime cash në mënyrë të përsëritur, por jo më shumë se 300.000 lekë. Pasqyrimi i lëvizjeve të mia financiare me bankë dhe me urdhër-pagesa, ndërtimi i kontratave për të gjitha proceset për ndërtimin e shtëpisë, përbëjnë qëndrim të hapur dhe të sqartë në këtë deklaram.

e) Lidhur me gjetjen se një apartament me sip. 68.8 m² në rrugën M.Sh. Tiranë, është blerë në datë 13.5.1999 në shumën 1.700.000 lekë (likuiduar nga Enti Kombëtar i Banësive) dhe është shitur nga subjekti në datë. 20.05.1999, pavarësisht se nuk ka asnjë koment nga ana e institucionit hetimor,verifikuesi e ka patur shumë të thjeshtë nëse do kishte parë certifikatën familjare të përfituesve nga statusi i të pastrehëve tek Enti i Banësive. Përfitues nga ky transaksion ka qenë tre kurorë. Prindërit e mi, vëllai i i vogël dhe unë + 5 fëmijë, ku 3 janë fëmijët e mi, dhe 2 të vëllait. Sigurisht që banesa që u ble nuk mund t'iu shërbente të gjithëve njëherësh dhe as nuk kishim përse të jetonim së bashku, pavarësisht nga aplikimi i përbashkët për statusin e të pastrehut. Kështu, ishte në dobinë e të treve që të shitej, të ndaheshin paratë, dhe secili të gjente zgjidhjen e tij.

f) Nuk është e vërtetë se unë kam deklaruar se jam larguar nga shoqata në vitin 2014. Ndërprerja e pagesave dhe vazhdimi i funksionit si vullnetar nuk është i barabartë me largimin nga shoqata. Nga ana tjetër institucionit i është vënë në dispozicion vendimi i këshillit kombëtar datë 28.06.2018, si dhe shpjegime se unë e kam dorëzuar detyrën me datë 28.07.2018, në kongresin e 5 i cili ka miratuar dorëheqjen time. Përveç sa më sipër, Presidenti i Shoqatës ka shpjeguar këto fakte zyrtarisht me shkresë. Siç është shpjeguar edhe nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, veçanërisht vendimet e këshillit kombëtar 2001, 2004, 2009, 2013 dhe 2018, si dhe akte të tjera bashkangjitur këtyre vendimeve, paga e presidentit përcaktohet sipas nenit 65 të statutit; në mbledhjen e parë të Këshillit Kombëtar, sipas një formule që vetë ky këshill përcakton. Formula është përcaktuar në vitin 2004, sipas të cilës paga e presidentit është sa 90% e Drejtorit të Përgjithshëm në Ministri, bazuar nga vendimi i Këshillit të Ministrave për sistemin e pagave në Republikën e Shqipërisë.

Në kongresin e 4-të të vitit 2014, në mbledhjen e parë të këshillit, unë kam hequr dorë nga marrja e pagës si president dhe kam vendosur të punoj si vullnetar. Këshilli kombëtar mori vendim për pezullimin e pagës mbi bazën e kërkesës time për një kohë të pacaktuar. Ndërkohë u vendos që do të vazhdonte pagimi i sigurimeve shoqërore mbi bazën e pagës maksimale zyrtare të përcaktuar me VKM. Siç është konfirmuar zyrtarisht nga Shoqata e të Verbërve, sigurimet shoqërore janë paguar deri më 31 Gusht 2018. Pas kësaj date e në vazhdim, sigurimet shoqërore janë paguar nga Instituti Kombëtar i Ekspertizës i personave me aftësi të kufizuar, ku unë jam kryeekspert vullnetar.

g) Për sa i përket konstatimit sipas të cilit kam marrë pagesën e doktoraturës edhe në Shoqatë, edhe pranë Njesisë Administrative nr.1, për shkak të verbërisë, nuk arrij të kuptoj se cili është problemi apo opinioni i institucionit hetimor në këtë rast. Nëse supozohet paligjshmëri në këtë fakt, ky supozim është i gabuar dhe i paligjshëm. Pajesa e doktoraturës për shkak të verbërisë, jepet për faktin e statusit personal që unë kam dhe bazohet në nenin 8 të ligjit 8098/1996 për statusin e të Verbërit dhe është e barabartë me dyfishin e pagesës bazë për shkak të verbërisë. Lidhur me verbërinë, jepen disa lloji pagesash si për kujdestari, arsimim, për strehim, transport etj. Sipas nenit 5 të po këtij ligji, pagesa për shkak të verbërisë, jepet pavarësisht nga të ardhura të tjera që përfitohen nga shteti dhe nuk llogariten në të ardhurat ekonomike/familjare. Së fundi, institucioni hetimor, nuk ka mbajtur parasysh faktin se Shoqata e të Verbërve nuk është një ent publik, dhe financimi i pagës së presidentit dhe administratës së tij, nuk bëhet me fonde publike. Ka qenë tërësisht në tagrin e organeve drejtuese të organizatës për të marrë çdo lloj vendimi lidhur me pagat, kështu që konstatimi në këtë rast është i pavend.

gj) Për sa i përket paqartësisë për blerjen e objektit në Durrës në vitin 2017, ajo vjen nga mungesa e thellimit në hetim, dhe shqyrtimit sipërfaqësor të dokumentacionit të dorëzuar. Në asnjë rresht të deklaratës time nuk gjendet fakti se unë jam larguar nga Shoqata në vitin 2014. Përkundrazi, në vendimin e Këshillit Kombëtar të datës 28.06.2018 si dhe në shkresën e Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë, është provuar fakti se unë kam dhënë dorëheqjen dhe jam larguar si president në kongresin e 5-të të kësaj shoqatë, më 28.07.2018. Nënshkrimi i aktit noterial të blerjes së selisë në Durrës, për degën përkatëse, ka qenë në tagrin tim statutor si përfaqësues ligjor i organizatës. Në këto rrethana paqartësia për këtë rast është një lajthitje.

h) Lidhur me konstatimet për mosdeklarimin tatimor të të ardhurave, bazuar në nenin 4 të ligjit 8098/1996, të verbërit përjashtohen nga çdo lloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë si persona fizik, përveç kur ata veprojnë si persona juridik. Bazuar në ligjin 8438/1998, neni 38 pika 7, të verbërit gëzojnë lehtësira dhe përjashtime sipas statusit të tyre. Ndërkohë Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ka nxjerrë shkresa e urdhëresa rast pas rasti për zbatimin e këtij ligji. Duhet të kuptohet qartë dhe përfundimisht se deklaratimet e bëra 0 ose pa aktivitet janë në përputhje me urdhërimet e organeve kompetente. Supozimi i organit hetimor se ne nuk përjashtohemi nga detyrimi për të deklaruar është i pabazuar, pasi në këtë rast rregullimet ligjore janë përjashtimore.

i) Lidhur me detyrimin për të deklaruar sipas statusit për profesionet e lira, pavarësisht nga vendimi i Gjykatës së Lartë, nga detyrimi për përjashtimin e avokatëve nga TVSH, me vendimin e qeverisë në Dhjetor 2018, unë jam përfshirë duke çelur pranë tatim taksave zërin e llogarisë, për deklarimin e librave të shitjes dhe të blerjes, si dhe jam pajisur me bllokun e faturave për të paguar tvsh. Është fare e qartë se të Verbërit nuk janë subjekt tatim-pagues që rimbursohen, por janë të përjashtuar si subjekte tatim-pagues. Rasti ku ata përfshihen si subjekt tatimpagues të rimbursueshëm, është vetëm kur ata detyrohen të paguajnë tatime indirekte siç është TVSH. Administrimi nga përjashtimi për tatimin mbi të ardhurat (si tatim direkt) është kompetencë ekskluzive e organit tatimor. Në periudha të ndryshme, qëndrimet e tyre ligjore dhe administrative kanë qenë të ndryshme. Pra ose e kanë lënë në heshtje, të papërcaktuar, dhe në këtë rast është zbatuar ligji në parim dhe drejtpërdrejt, duke mos u trajtuar si subjekte tatimore, ose kanë përcaktuar raste të deklarimit pa aktivitet ose 0.

j) Lidhur me konstatimin nga ILDKPKI se është i panjohur burimi i krijimit të shumës 7.060.600 lekë nga E.G., për pagesën e apartamentit në bashkëpronësi me G.T., si dhe për pjesën që tek seksioni i Hipotekave nuk rezulton të jetë vendosur apartamenti si kolateral për kredi, sqaroj se Z. E.G. për momentin nuk bën pjesë në rrethin e personave për të cilët unë kam detyrim të bëj deklaram. Megjithatë E.G. është partner i vajzës time, ku pritet që ata të krijojnë familje. Blerja e apartamentit së bashku i është mundësuar të dyve nga prindërit përkatës. Përsa i përket G.T., deklarami është bërë i plotë dhe i qartë. Përsa i përket E.G., shifra e përmendur nga organi hetimor është siguruar nga financimi i prindërve dhe nga kursimet e pagës së tij. Këtij deklarami i bashkangjiten dokumentacioni bankar dhe deklarata e E.G. .

k) Lidhur me mungesën e dokumentacionit justifikues ligjor për përfitimin e shumës 354 Euro/Muaj nga shteti Spanjoll për statusin për jetë të pavarur, sqaroj se në momentin më të parë të mundur, do të vendoset në dispozicion dokumenti ligjor që provon përfitimin e kësaj shume prej afro 10 vjetësh, si dhe rezultatet e aplikimit të bërë në muajin Prill 2019 për pension jo kontributiv. Takimi për të plotësuar formularin e kërkesës është lënë me datë 01.07.2019 në orën 12.30. Agjencia Madrilenë de Atencion Social. Calle de Agustin de Foxa nr.31, 38036 Madrid.

47. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi përputhshmërinë e të dhënave të deklaruara nga kandidati Sinan Tafaj në Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë që ka depozituar pranë ILDKPKI, mbi bazën e të cilave ky institucion ka realizuar analizën financiare dhe ka ardhur në përfundimet e tij, në raport me të dhënat që rezultojnë nga informacionet e dërguara pranë Këshillit nga institucionet publike dhe private të treguara në pikën 15 të këtij Vendimi, si dhe shpjegimet dhe dokumentacionin shtesë të paraqitur nga kandidati Sinan Tafaj.

48. Nga analiza e akteve, të dhënave dhe gjetjeve Këshilli i Emërimeve në Drejtësi konstaton se subjekti ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar burimet i ligjshme të të pasurisë së personave huadhënës prej të cilëve ka përfituar hua, si edhe nuk ka respektuar ligjin lidhur me detyrimet për deklarimin e të ardhurave si subjekt tatimpagues ose si individ.

49. Në lidhje me gjetjen dhe përfundimin e ILDKPKI se ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për përftimin e shumës 354 euro/muaj nga shteti spanjoll, me statusin për jetë të pavarur, kandidati Sinan Tafaj ka shpjeguar se në momentin më të parë të mundur, do të vendoset në dispozicion dokumenti ligjor që provon përfitimin e kësaj shume prej afro 10 vjetësh dhe se, për këtë qëllim do të mundësojë paraqitjen e dokumentacionit pas datës 1 Korrik 2019 kur do të paraqitet sipas konfirmimit përpara autoriteteve spanjolle. Këshilli vëren se, edhe pas kësaj date, deri në ditën e shqyrtimit të gjetjeve mbi kandidatin Sinan Tafaj, ky i fundit nuk ka paraqitur dokumentacionin e pretenduar prej tij.

50. Në lidhje me gjetjen dhe përfundimin e ILDKPKI mbi dokumentacion justifikues jo të plotë ligjor për burimin e krijimit të shumës totale 60.000 euro nga tre huadhënës të ndryshëm (secili 20.000 euro), kandidati Sinan Tafaj, në thelb ka shpjeguar se huadhënësi F.T., së bashku me vëllain e tij R.T., kanë punuar në Greqi për një periudhë të gjatë dhe janë djemtë e xhaxhait, të cilët, prej disa vitesh kanë ngritur edhe një biznes të përpunimit të mermerit. Shpjegimet dhe dokumentacioni (vula e viza në pasaportë dhe një dokument pronësie automjeti) të paraqitura nga kandidati nuk mund të shërbejnë si mjete provuese të

ligjshme për të treguar jo vetëm mundësinë e tyre për të pasur këto të ardhura por edhe burimin e ligjshëm të krijimit të tyre. Në të njëjtën gjendje mangësie të mjeteve provuese të ligjshme është edhe rasti i huadhënësit tjetër A.C. (nip i kandidatit) në shumën 20.000 euro, për të cilin nuk paraqitet dokumentacion konkret i pranueshëm sipas ligjit për të treguar se nëpërmjet ushtrimit të profesionit të mjekut në spital publik apo klinikë private apo nga emigracioni në Itali i ka krijuar këto të ardhura dhe burimin e ligjshëm përkatës. Gjithashtu, në të njëjtën gjendje mangësie të mjeteve provuese të ligjshme të krijimit të të ardhurave dhe ligjshmërisë së tyre është edhe rasti i huadhënies prej 20.000 euro nga O.T., nip i kandidatit Sinan Tafaj.

51. Një tjetër gjetje dhe përfundim i ILDKPKI është se, pavarësisht se nga statusi i të verbërit që përjashton pagesën e tatimeve dhe taksave si person fizik, kemi të bëjmë me shkelle të ligjit sepse ka mosdeklarim të të ardhurave nga ushtrimi i profesionit të avokatit, për të cilin, p.sh. të ardhurat janë deklaruar 0 (zero) lekë për vitin 2014, 2017, 2018 dhe 2019, sikurse edhe mosdeklarim të tyre në deklaratën e interesave private të kandidatit. Po kështu, nuk ka pasur deklarime mbi të ardhurat e siguruar nga qiradhënia e pasurive të paluajtshme prej 2.514.000 lekë. Kandidati Sinan Tafaj, në shpjegimet e tij parashtron se, bazuar në nenin 4 të ligjit 8098/1996, të verbërit përjashtohen nga çdo lloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë si persona fizik, përveç kur ata veprojnë si persona juridik. Deklarimet e bëra 0 ose pa aktivitet janë në përputhje me urdhërimet e organeve kompetente. Është fare e qartë se të verbërit nuk janë subjekt tatim-pagues që rimbursohen, por janë të përjashtuar si subjekte tatim-pagues. Rasti ku ata përfshihen si subjekt tatimpagues të rimbursueshëm, është vetëm kur ata detyrohen të paguajnë tatime indirekte siç është TVSH.

52. Këshilli vlerëson se shpjegimet e kandidatit Sinan Tafaj nuk gjejnë mbështetje në ligj. Në legjislacionin tatimor ka një dallim të qartë ndërmjet rrethit të subjekteve që kanë detyrimin të deklarojnë ose përjashtohen nga deklarimi dhe rrethit të subjekteve që detyrohen të paguajnë taksa e tatime ose që përjashtohen nga pagimi i tyre. Një ndër rastet është ai i subjekteve apo individëve që kanë detyrimin të deklarojnë të ardhurat por janë të përjashtuar nga detyrimi i pagesës së taksave apo tatimeve për ato të ardhura. Përjashtimi nga detyrimi për deklarimin e të ardhurave duhet të parashikohet shprehimisht nga ligji. Ndërkohë që, përjashtimi nga detyrimi për të paguar taksa apo tatime, i cili gjithashtu duhet të parashikohet shprehimisht nga ligji, nuk ka lidhje dhe nuk nënkupton edhe përjashtimin nga detyrimi ligjor për deklarimin e të ardhurave Detyrimi për deklarimin e të ardhurave nuk ka si qëllim të vetëm përlllogaritjen dhe verifikimin e përmbushjes së detyrimit për të paguar taksa dhe tatimet përkatëse, por parashikohet edhe për qëllime të tjera që i ka vlerësuar ligjvënësi për të mirën publike dhe administrimin e punëve me interes publik. Për këto arsye, Këshilli konkludon se kandidati Sinan Tafaj nuk e ka respektuar ligjin duke mos i deklaruar të ardhurat, edhe pse sipas ligjit nr. 8098/1996 është i përjashtuar nga detyrimi i pagesës së taksave dhe tatimeve të caktuara nga ligji.

53. Pa qenë e nevojshme që të trajtohen dhe konkludohet mbi gjetjet e tjera të ILDKPKI dhe prapësimet e shpjegimet përkatëse të argumentuara hollësisht të kandidatit Sinan Tafaj lidhur me to, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se arsyetimi që parashtrohet në pikat 49-52 më sipër, mbi gjetjet në procedurën e verifikimit të pasurisë dhe ligjin e zbatueshëm lidhur me to, është i mjaftueshëm për të ardhur në përfundimin se kandidati Sinan Tafaj gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për mospërmbushje të kushtit ligjor të parashikuar nga shkronja “dh” e nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe neni 235 i Ligjit nr. 115/2016.

54. Këshilli vlerëson se kushtet e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligjet e nxjerra në pajtim me të, duhet të plotësohen secila dhe të gjitha së bashku në mënyrë që kandidati të pranohet për tu vlerësuar dhe renditur sipas meritave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe më tej për tu përzgjedhur gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nga organi i emërtesës. Në rast se kandidati nuk plotëson qoftë edhe njërin prej kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, kjo do të përbënte motiv ligjor të mjaftueshëm për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi për të disponuar ndalimin e kandidimit, pa qenë më e nevojshme të arsyetojë për plotësimin ose jo të kushteve të tjera ligjore.

55. Për këto arsye, duke ardhur në përfundimin se në lidhje me kandidatin Sinan Tafaj është i mjaftueshëm të vendoset ndalimi i kandidimit për motivin e mosplotësimin të kushtit ligjor të përcaktuar nga shkronja "dh" e nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe neni 235 i ligjit nr. 115/2016, Këshilli vlerëson se nuk është vendi për të vijuar me tej me analizë dhe arsyetim mbi plotësimin ose jo të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit.

56. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset ndalimi i kandidimit të kandidatin Sinan Tafaj, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Kuvendi në datën 28.08.2018.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 7/a dhe 7/c të ligjit nr. 8577/2000 " *Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*" të pikës 3 të nenit 229 dhe pikës 4 të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 " *Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*", si edhe të shkronjës "b" të pikës 50 dhe shkronjës "a" të pikës 77 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 " *Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Ndalimin e kandidimit të kandidatin Sinan Tafaj, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Kuvendi në datën 28.08.2018.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatin Sinan Tafaj.
3. Kandidati Sinan Tafaj ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

Ardian DVORANI